Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	: Syllabuset e Programit të Studimit “Studime në Shkenca Ushtarake” tregojnë se vlerësimi i dijeve të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Ky proces përfshin pjesëmarrjen aktive në seminare, laboratorë dhe praktika mësimore, si dhe ndarjen e vlerësimit me teste në dy pjesë, sipas përcaktimeve të syllabuseve. <i>Evidenca 28</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Evidenca 28: Syllabuset e Programit të Studimit “Studime në Shkenca Ushtarake” tregojnë se vlerësimi kombinohet përmes metodës “pencil and paper”, vlerësimit me gojë, dhe vlerësimit elektronik, i cili përfshin hartimin, postimin dhe prezantimin/mbrojtjen e detyrës ose projektit të kursit. <i>Evidenca 28</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Urdhërat e provimeve tregojnë se testet ndërmjetëse dhe finale administrohen në mënyrë të sigurt nga sekretaria mësimore, e cila i sekretion dhe më pas i dekodon pas vlerësimit anonim nga pedagogu. Vlerësimi i dijeve kryhet gjithmonë nga dy pedagogë: njëri është titullari i lëndës, ndërsa tjetri është pedagog i së njëjtës lëndë ose i një lënde të përafërt. <i>Evidenca 3: Rregullore Programi; Evidenca 47:</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Programi tregon se vlerësimi i të gjithë komponentëve, përfshirë pjesëmarrjen aktive në seminare, detyrën e kursit, testin ndërmjetës dhe testin final, shoqërohet me feedback dhe komente të detajuara nga pedagogët. Pas zhvillimit të testeve, organizohet një seancë sqaruese me studentët, ku qartësohen kriteret e vlerësimit, dhe ata kanë mundësinë të ballafaqohen me vlerësimin dhe cilesinë. <i>Evidenca 3: Rregullore Programi</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Të gjitha detyrat e kursit dhe projektet i nënshtrohen kontrollit për plagjiaturë, duke garantuar integritetin akademik. Ndërkohë, testet ndërmjetëse dhe finale administrohen në prani të dy pedagogëve, të cilët sigurojnë respektimin e rregullores dhe zbatimin e masave disiplinore në rast kopjimi, sipas përcaktimeve të Kodit të Etikës dhe Rregullores së AFA <i>Evidenca 3: Rregullore Programi; Evidenca 48: Kodi i Etikës së AFA; Evidenca 49: Rregullore e Kodit të Etikës AFA.</i>			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e testeve ndërmjetëse dhe finale publikohen brenda 7 ditëve nga data e zhvillimit të tyre. Studentët i marrin rezultatet individualisht, në përputhje me standardet etike, gjatë seancave sqaruese të organizuara për këtë qëllim <i>Evidenca 3: Rregullore Programi</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Pas çdo testi ndërmjetës dhe final, pas publikimit të rezultateve, organizohet një seancë sqaruese, ku studentët njihen me cilësinë dhe vlerësimin e punës së tyre, si dhe me përgjigjet e pyetjeve objektive dhe subjektive të testit. Në rast se studentët argumentojnë për diferenca në vlerësim, çështja shqyrtohet nga një komision i përbërë nga dy pedagogë dhe përgjegjësi i departamentit. Nëse pas rivlerësimit konfirmohen ndryshime në pikëzim, ato reflektohen në test, duke u firmosur nga pedagogët dhe regjistruar në sekretari <i>Evidenca 3: Rregullore Programi; Evidenca 9: Rregullore Fakulteti.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i "Studimeve në Shkenca Ushtarake" siguron një vlerësim transparent dhe të drejtë për studentët, përmes metodave të ndryshme si pjesëmarrja, detyrat e kursit dhe testet. Procesi përfshin feedback të detajuar, seanca sqaruese dhe kontroll për plagjiaturë, duke garantuar objektivitet dhe përputhje me rregulloret dhe etikën akademike</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit si në kurrikulën e tij dhe në syllabus-et e lëndëve/moduleve të veçanta synon zhvillimin e dijeve të studentëve, avancimin e tyre shkencor, teknik dhe profesional në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Nga natyra e programit dhe lëndëve që e përbëjnë atë, fokusi kryesor është zhvillimi i njohurive dhe aftësive të avancuara në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Gjithashtu, programi synon një formim të plotë të studentëve, duke përfshirë zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik, zgjidhjes së problemeve dhe respektimin e parimeve etike dhe humane.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabus-et e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të çdo semestri, departamenti, fakulteti dhe AFA analizojnë dhe diskutojnë nivelin e kompetencave profesionale të fituara nga studentët, sfidat për arritjen e tyre, metodat e përdorura në mësimdhënie dhe aktivizimin e studentëve, me qëllim përmirësimin e procesit në të ardhmen. Në javën e 7, përpara testit ndërmjetës, dhe në javën e 15, përpara testit final, pedagogët shpjegojnë përmbajtjen mbi të cilën do të bazohet formulimi i testeve.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i studimit mbështet zhvillimin e aftësive të studentëve përmes prezantimeve, detyrave kursi dhe projekteve. Mësimdhënia zhvillohet në një klimë diskutimi dhe ndërveprimi, duke inkurajuar punën në grup dhe formimin e aftësive të punës në ekip. Pedagogët mbështesin idetë e studentëve dhe i ndihmojnë të zhvillojnë projekte aplikative dhe kërkimore. Akademia mbështet idetë inovatore dhe ofron mundësi financimi për projekte kërkimore të suksesshme.

Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të programit të studimit, përveç mësimdhënies, angazhohen në aktivitete të tjera si seminare, workshop-e dhe prezantime teknologjish, të cilat organizohen në auditorë të zgjeruara. Këto aktivitete përfshijnë jo vetëm studentët e programit të studimit, por edhe studentë dhe pedagogë nga programe të tjera të fakulteteve të ndryshme.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka krijuar struktura të posaçme në nivel institucional për të promovuar dhe rritur vetëdijen për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke siguruar një qasje të vazhdueshme dhe të strukturuar për përmirësimin e proceseve akademike në programet e studimit..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Evidenca 3 Rregullore Programi; Evidenca 50 Udhëzimi për përgatitjen e temës së diplomës; Evidenca 51 Urdhër diplome, pyetje referuese tregojnë se Personeli akademik asiston studentët duke u ofruar informacione dhe udhëzime mbi materialet e nevojshme për përgatitjen e tezës së diplomës. Departamenti organizon seanca metodologjike për hartimin e temave dhe seanca mbështetëse për studentët që do të japin provimin e përgjithshëm përfundimtar, duke i informuar mbi përmbajtjen e tezës, natyrën e testeve dhe kriteret e vlerësimit. <i>Evidenca 3 Rregullore Programi; Evidenca 50 Udhëzimi për përgatitjen e temës së diplomës; Evidenca 51 Urdhër diplome, pyetje referuese</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Personeli akademik asiston studentët në përgatitjen e tezës së diplomës, duke u ofruar informacione dhe udhëzime mbi materialet e nevojshme. Departamenti organizon seanca metodologjike për hartimin e temave të diplomës dhe seanca mbështetëse për studentët që përgatiten për provimin e përgjithshëm përfundimtar, duke i informuar mbi përmbajtjen e tezës, natyrën e testeve dhe kriteret e vlerësimit. <i>Evidenca 3 Rregullore Programi; Evidenca 50 Udhëzimi për përgatitjen e temës së diplomës; Evidenca 51 Urdhër diplome, pyetje referuese</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna	Komisioni i vlerësimit të tezave të diplomës zbaton standardet e hartimit të tezës, të cilat u ofrohen studentëve përpara procesit të përgatitjes së diplomës. Ndërkohë, Komisioni i vlerësimit të provimit të përgjithshëm

gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	përfundimtar analizon formimin akademik të studentëve gjatë tre viteve të studimit, duke u bazuar në rregulloret e FMS dhe AFA. <i>Evidenca 3 Rregullore Programi; Evidenca 50 Udhëzimi për përgatitjen e temës së diplomës; Evidenca 51 Urdhër diplome, pyetje referuese</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në dokumentacionin personeli akademik i programit Bachelor në "Studime në Shkenca Ushtarake" orienton dhe mbështet studentët në përgatitjen e testeve për provimin e përgjithshëm përfundimtar dhe zgjedhjen e temave të diplomës, duke u bazuar në ekspertizën e pedagogëve. Studentët zhvillojnë takime periodike për konsultime mbi temat dhe çështjet përkatëse. Pas përfundimit të diplomës, ata depozitojnë kopjet e firmosura nga udhëheqësi dhe një kopje në format PDF në sekretarinë mësimore.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, Komisioni vlerëson se studentët e programit Bachelor në "Studime në Shkenca Ushtarake" marrin mbështetje nga stafi akademik, veçanërisht nga udhëheqësit e temave, në dizejnimin e studimeve, ndërtimin e instrumenteve, mbledhjen e të dhënave dhe realizimin e analizave deskriptive dhe inferenciale për hartimin e tezave të diplomës.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në procedurën e diplomimit dhe programin mësimor Bachelor "Studime në Shkenca Ushtarake", studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm ose hartojnë temë diplome vlerësohen me notën përkatëse dhe marrin kreditet e përcaktuara pas përfundimit të procesit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjithashtu, me kërkesë të tij, ai mund të marrë një kopje zyrtare të plotë të programit të studimit Bachelor "Studime në Shkenca Ushtarake". <i>Evidenca 3 Rregullore Programi; Evidenca 50 Udhëzimi për përgatitjen e temës së diplomës; Evidenca 52 Suplementi diplomës dhe diploma, në përfundim të studimeve</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast	Sekretaria Mësimore e FMS ruan një kopje të dokumentacionit të çdo studentit për një afat të pacaktuar, duke siguruar një bazë dokumentare fizike për çdo informacion të mëvonshëm në lidhje me studentët. <i>Evidenca 53 Rregullore e sekretarisë mësimore,</i>

pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.				
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe të strukturuar për përfundimin e detyrimeve të studentëve në programin e studimit, duke siguruar që ata të pajisen me dokumentacionin përkatës, duke garantuar një proces të drejtpërdrejtë dhe të besueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ndjek një politikë transparente të punësimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore, në përputhje me LAL, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme. Për plotësimin e Tabelës së Organizimit dhe Pajisjeve (TOP), AFA zbaton politika të qarta për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, civil dhe ushtarak, bazuar në ligjin 64/2014, ligjin 80/2015 dhe VKM nr. 156, datë 19.02.2020. Personeli ushtarak dhe civil brenda FA emërohet me propozim të Komandantit/Rektorit të AFA, përmes Shefit të SHPFA dhe miratimit të Ministrit të Mbrojtjes. Punësimi i personelit akademik dhe ekspertëve me kohë të pjesshme kryhet në përputhje me Statutin, Rregulloren e Brendshme të AFA, Rregulloren e Bordit të Administrimit dhe legjislacionin në fuqi, duke u bazuar në kërkesat e departamenteve dhe numrin limit të miratuar nga BA. Çdo vit akademik, AFA synon afrimin e personaliteteve dhe specialistëve të fushave përkatëse, me qëllim pasurimin e procesit të mësimdhënies me dije të specializuara teorike dhe praktike. <i>Evidenca 39 – CV i personelit akademik</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë	

ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv mbulon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore, në raport me personelin akademik me kontratë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore përcaktohet në fillim të vitit akademik, duke u bazuar në kualifikimet dhe certifikimet e personelit. Lëndët dhe modulet mbulohen sipas gradave dhe titujve shkencorë, në përputhje me Udhëzimin nr. 29/2018 për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Stafi i programit ndër vite është: 2021-2022 25 PAE 2022-2023 38 PAE 2023-2024 24 PAE/2 PAK Personeli akademik me kohë të plotë angazhohet në mësimdhënie në përputhje me fushën e programit të studimit, natyrën dhe specifikat e lëndëve/moduleve. CV-të e tyre pasqyrojnë fushat e interesit dhe kërkimit shkencor, të cilat përputhen me lëndët që mbulojnë në këtë program. <i>Evidenca 39 – CV i personelit akademik; Evidenca 54 – Planifikimi i ngarkesës mësimore për vitin akademik DSHU 2023-2024; Evidenca 55 – Planifikimi i ngarkesës mësimore për vitin akademik DSHU 2024-2025, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë përbëhet nga 1 Profesor Dr., 5 Profesorë Asoc., 13 Lektorë (Dr.) dhe 33 Asistent Lektorë.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me siguri shoqërore dhe shëndetësore.	AFA siguron përmbushjen e çdo kërkesë kontraktuale me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, duke respektuar detyrimet e Kodit të Punës. Funksionimi i institucionit, procedurat dhe kriteret e emërimit të personelit civil dhe ushtarak janë të përcaktuara në aktet rregullatore të Ministrisë së Mbrojtjes. AFA zbaton politika që garantojnë qëndrueshmërinë e stafit akademik, duke minimizuar lëvizjet e shpeshta dhe ndikimet e tyre në standardet e cilësisë. Institucioni gjithashtu përmbush kriteret ligjore për raportin student/staf akademik dhe numrin e personelit akademik të kualifikuar në njësitë bazë. Çdo departament ka të paktën shtatë anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët të paktën tre mbajnë gradë shkencore ose titull akademik. <i>Evidenca 55.1 – Kontratat e punës së personelit akademik dhe Vendimin nr. 117 për administrimin e dosjeve të personelit</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur	AFA siguron transparencë në rekrutimin e personelit akademik, duke publikuar organigramën dhe kriteret e punësimit në faqet e saj zyrtare. Procesi i punësimit realizohet me konkurim të hapur, duke garantuar transparencë dhe paanshmëri. Stafi akademik përfshin persona me kohë të plotë dhe të pjesshme, civil ose ushtarak, sipas nevojave të programeve të studimit

të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga vezhgimet dhe dokumentacioni vërehet se AFA është e angazhuar për të siguruar një personel ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve mësimore në gjendje optimale. Kjo përputhet me natyrën specifike të programit të studimit, duke synuar një përvojë të pasur mësimore për studentët. Gjithashtu, AFA vlerësohet se po investon në përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe mjediseve mësimore, në përputhje me nevojat akademike dhe përparimet teknologjike. Aktualisht, në bashkëpunim me AKSHI, janë në proces prokurimi pajisje IT për të rritur cilësinë e mësimdhënies.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga dokumentacioni vërehet se të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore/DAK, e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik (me kohë të plotë, të pjesshëm dhe administrativ), ku depozitohet i gjithë dokumentacioni përkatës. Gjithashtu, kjo zyrë mban evidencë për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për çdo semestër.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën	AFA ka zhvilluar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me institucione akademike, përfaqësues biznesi dhe kompani, për të siguruar personel të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale, orientimit akademik dhe procesit të diplomimit. Praktika profesionale është e detyrueshme, vlerësohet me notë dhe ka kreditet e përcaktuara në programin e studimit. Në këtë kuadër, AFA ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, të cilat garantojnë mbështetjen e studentëve nga personel i kualifikuar në përputhje me natyrën e programit. Personeli akademik luan një rol kyç në këtë bashkëpunim,

profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	duke ndihmuar studentët të aftësohen profesionalisht, të njihen me tregun e punës dhe të krijojnë lidhje akademike e profesionale. <i>Evidenca 14, 15 dhe 21</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	AFA ka përcaktuar politika dhe procedura të qarta për të siguruar që personeli mbikëqyrës në ambientet pritëse të angazhohet efektivisht në zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Ata janë të përgatitur për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve të praktikës, raportit përfundimtar dhe të marrin pjesë aktive në vlerësimin e tyre. Personeli mbikëqyrës i praktikave ka detyrime të përcaktuara në udhëzuesin e praktikave dhe raportet përfundimtare të studentëve. Mbikëqyrja realizohet nga personeli akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, ndërsa përgjegjësi i departamentit siguron shpërndarjen dhe monitorimin e praktikës profesionale. Institucionet pritëse për praktikën profesionale duhet të ofrojnë mundësi eksperience për studentët, të informojnë ata mbi mjedisin e punës dhe proceset ku do të angazhohen, të caktojnë një udhëheqës mbikëqyrës, i cili do të orientojë studentin dhe do të shërbejë si ndërfaqe midis institucionit dhe akademisë, si dhe të plotësojnë formularin e vlerësimit të studentit, duke e dorëzuar atë tek pedagogu përgjegjës brenda afateve të përcaktuara. <i>Evidenca 14, 15 dhe 21</i>			
Konkluzione	Në përfundim, Standardi IV.1 konstaton se personeli akademik që mbulon programin e studimit përmbush plotësisht kërkesat sasiore dhe ka kualifikimin akademik të nevojshëm dhe të posaçëm, në përputhje me fushën e programit, duke garantuar standardet e nevojshme për mësimdhënie dhe cilësinë e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike	Infrastruktura, institucioni disponon salla me kapacitete të ndryshme, të cilat akomodojnë studentët sipas llojit të veprimtarisë dhe në përputhje me normativat në fuqi. Objekti është i organizuar në ambiente të dedikuara për veprimtarinë akademike dhe administrative, përfshirë auditorët e mësimi, hapësirat për personelin akademik dhe administrativ, bibliotekën, sallat audiovizive, laboratorët e kompjuterëve dhe shërbimet për studentët.

të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjithashtu, infrastruktura përfshin arkivën dhe magazinat, si dhe poligonet stërvitore për temat specifike ushtarake. Për funksionimin teknik të godinës janë të disponueshme sistemet e kondicionimit, motor gjeneratorët, depozitat e ujit, elektropompat dhe kabinat elektrike. Objekti përmban gjithashtu hapësira të dedikuara për parkim dhe ambiente të jashtme në shërbim të studentëve dhe stafit. <i>Evidenca 37 – Infrastruktura</i>			
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Infrastruktura për mbështetjen e programeve të studimit, ambientet e dedikuara për mësimdhënien, stafin dhe shërbimet ndaj studentëve janë të pajisura me tavolina, karrige, kompjuterë, projektorë dhe mjete të tjera që mundësojnë zhvillimin e aktivitetit akademik dhe administrativ në mënyrë optimale. Studentët kanë akses të plotë në rrjetin LAN, ndërsa godina është e mbuluar plotësisht me Wi-Fi, duke lehtësuar përdorimin e infrastrukturës për procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Për të siguruar cilësi në mësimdhënie, Akademia e Forcave të Armatosura ka ngritur një sistem vlerësimi online për pedagogët dhe lëndët, duke mundësuar një monitorim të vazhdueshëm të standardeve akademike. <i>Evidenca 37 – Infrastruktura dhe Evidenca 14 – Urdhëri i SHSHPFARSH</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateli të apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Ambientet e dedikuara për mësimdhënien, stafin dhe shërbimet ndaj studentëve janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme, duke përfshirë tavolina, karrige, kompjuterë dhe projektorë, të cilat sigurojnë zhvillimin e rregullt të aktiviteteve institucionale dhe mundësojnë realizimin e suksesshëm të programit të studimit.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni disponon 2 laboratorë modernë të pajisura me rreth 60 laptopë me parametra bashkëkohorë, si CPU iCore5 Gen 11, 16GB RAM dhe 500 SSD. Në këto pajisje janë të instaluar software të nevojshëm për procesin mësimor dhe kërkimin shkencor, përfshirë Microsoft Office365 ProPlus, Eclipse IDE, PyCharm, Adobe Acrobat Reader DC, Cisco Packet Tracer, Wireshark, TeamViewer, Avast Antivirus, dhe XAMPP Control Panel			
Konkluzione	<i>Në përfundim, institucioni i arsimit të lartë siguron mjedise mësimore dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimdhënës dhe formimin praktik, të përshtatshme për natyrën dhe fushën e programit të studimit. Kjo mundëson realizimin efektiv të aktiviteteve mësimore dhe kërkimeve shkencore të studentëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në Syllabuset e Programit të Studimit “Studime në Shkenca Ushtarake”, personeli akademik përcakton në programin e lëndës literaturën bazë të detyrueshme, e botuar në pesë vitet e fundit nga shtëpi botuese prestigjioze, si dhe një listë literature ndihmëse për lexim plotësues mbi temat e programit mësimor. Kjo literaturë është e disponueshme për studentët në gjuhën e programit të studimit, si në format fizik ashtu edhe digjital, duke siguruar akses të lehtë në burimet e nevojshme për përvetësimin e dijes dhe njohurive të parashikuara në programin akademik. <i>Evidenca 28 – Syllabuset e Programit të Studimit “Studime në Shkenca Ushtarake”,</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Biblioteka e AFA është e pajisur me literaturë bashkëkohore, e cila përditësohet rregullisht për të siguruar burime cilësore për studentët dhe stafin akademik. Ajo ofron akses 24/7 në literaturë elektronike, ndërsa AFA investon në abonime për bazat e të dhënave shkencore. Për më tepër, shërbimi i bibliotekës vlerësohet periodikisht përmes sondazheve të rregullta. <i>Evidenca 28 biblioteka e AFA</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	AFA në bibliotekë disponon literaturë bashkëkohore, e cila përditësohet rregullisht dhe vihet në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. Për të lehtësuar aksesin, stafi akademik ngarkon literaturën digjitale në Share Folder të AFA, i cili është i aksesueshëm për të gjithë personelin dhe studentët. Shërbimet e bibliotekës janë gjithmonë të disponueshme, duke përfshirë edhe literaturën elektronike, e cila mund të përdoret 24/7. Bibliotekat e AFA janë të pajisura me libra dhe revista shkencore, të cilat mbështesin përmirësimin e programeve të studimit. Për të nxitur kërkimin shkencor, AFA alokon fonde vjetore për abonime në bazat e të dhënave shkencore dhe blerjen e revistave shkencore. Gjithashtu, shërbimi i bibliotekës vlerësohet periodikisht përmes sondazheve të përdoruesve. <i>Evidenca 31 – Lista e literaturës në gjuhën shqipe dhe Evidenca 32 – Lista e literaturës në gjuhë të huaj,</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë,	AFA ofron një bibliotekë të pasur me literaturë specifike për fushën ushtarake, si dhe literaturë të përgjithshme dhe teknike. Aktualisht,

literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	biblioteka disponon 9,467 tituj fizikë në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj. Departamentet e FMS dhe IKSHU propozojnë çdo vit literaturë të re në gjuhën shqipe dhe angleze, e cila miratohet nga SA dhe BA. Biblioteka është e hapur për studentët nga ora 08:00 deri në 21:00, duke ofruar manuale dhe doktrina ushtarake të një periudhe mbi tre dekada, si dhe punime doktorature të mbrojtura në AFA që prej fundit të viteve '80. Gjithashtu, ajo ofron tituj periodikësh në shqip dhe në gjuhë të huaj, si dhe tekste mësimore të miratuara nga SA, të cilat janë të ngjashme me ato të përdorura nga vendet partnere në NATO. <i>U vu re mungesa e materialeve dhe teksteve të shkruara në gjuhën shqipe për fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.</i> Biblioteka e AFA disponon një fond digjital leksionesh të aksesueshme online për studentët dhe është pjesë e marrëveshjes me RASH, duke siguruar akses në bibliotekën EBSCO, përveç sistemit Pitagora. Për lehtësimin e kërkimit dhe aksesit në materiale, biblioteka është e pajisur me 30 poste kompjuterësh, ndërsa rrjeti i saj është i brendshëm për arsye sigurie. <i>Evidenca 31 – Lista e literaturës në gjuhën shqipe dhe Evidenca 32 – Lista e literaturës në gjuhë të huaj,</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë të interesuar. Aksesit nëpërmjet pc të instaluar, i studentëve është pa pagesë
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e AFA është e pajisur me 30 njësi desktop, të cilat studentët mund t'i përdorin për qëllime mësimore, kërkim shkencor dhe përpunim detyrash. Kompjuterët funksionojnë me sistem operativ Windows 10/11, janë të pajisur me Microsoft Office 16 dhe aplikacione të licencuara, duke ofruar mbështetje për procesin akademik dhe praktikën mësimore. Për më tepër, personeli akademik përdor platforma online si Zoom dhe Google Classroom për të mbështetur dhe lehtësuar procesin e mësimdhënies.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Orari i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon nga e hëna në të premte, në orarin 08:00 – 21.00. Gjatë sezonit të provimeve në funksion edhe të kërkesës së studentëve, është e hapur në orar më të zgjatur

Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Fondi i bibliotekës së AFA është i pasur dhe rritet në mënyrë të vazhdueshme përmes blerjeve dhe donacioneve, si pjesë e objektivave të institucionit. Përgjegjësit e programeve hartojnë plane për shtimin e literaturës në mbështetje të studimeve, duke siguruar burime të përditësuara për studentët dhe pedagogët. AFA investon në botime periodike dhe elektronike, duke alokuar fonde të dedikuara për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi dhe kërkim shkencor.			
Konkluzione	<i>Ky programi i studimit ofron literaturë të përditësuar dhe të nevojshme për mësimdhënie, duke siguruar gjithashtu mjedise mbështetëse të mësimnxënies, siç janë biblioteka dhe mjediset e posaçme, për të siguruar një përvojë mësimore efikase për studentët</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	AFA përdor Google Classroom për të mundur shkëmbimin e materialeve mësimore, diskutime dhe ndarjen e detyrave, ndërsa sistemi "Pitagora" po implementohet për menaxhimin e sekretarisë mësimore, duke ndihmuar përgjegjësit e njësive dhe sekretaritë për ndarjen dhe raportimin e ngarkesës mësimore. AFA ka zhvilluar dhe përshtatur sisteme IT për të mbështetur personelin akademik dhe studentët. Sistemi i kontratave menaxhon informacionin personal dhe financiar të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, duke thjeshtuar procedurat dhe automatizuar gjenerimin e kontratave.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin,	Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) përdor Intranetin e brendshëm "ShareFolder" për menaxhimin dhe aksesimin e dokumentacionit, duke mundur një strukturë të organizuar informacioni sipas hierarkisë përkatëse. SHARE Folder mbështet

dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	procesin mësimor, duke siguruar akses të shpejtë dhe të sigurt për stafin akademik dhe studentët. AFA implementon dhe përditëson programe dhe sisteme të menaxhimit, si dhe rrjete të brendshme të komunikimit, në nivel të klasifikuar dhe jo të klasifikuar. Të gjithë anëtarët e personelit kanë akses në sistemet e menaxhimit të institucionit, ndërsa sistemet e informacionit ofrojnë shërbime të dedikuara për stafin dhe studentët, duke lehtësuar funksionimin institucional.			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	AFA implementon dhe përditëson vazhdimisht sisteme dhe programe menaxhimi, si dhe rrjete komunikimi të klasifikuar dhe jo të klasifikuar. Të gjithë punonjësit kanë akses në këto sisteme, ndërsa menaxhimi i dokumentacionit realizohet përmes Intranetit të brendshëm "ShareFolder", i cili siguron akses të strukturuar dhe shërbime të dedikuara për stafin, studentët dhe përdoruesit e autorizuar.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi ofron mundësi për pyetje, administrimin e materialeve dhe komunikim në kohë reale, ndërsa sistemi Pitagora siguron shërbim të shpejtë dhe ofron të dhëna për analiza nga organet drejtuese Google Classroom në AFA mundëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve mësimore midis pedagogëve dhe studentëve, duke rritur cilësinë e mësimnxënies.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platforma Google Classroom shërben si një mjet efikas për NJSBC-në, por edhe për të gjithë institucionin, në monitorimin e procesit akademik përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga sistemi. Në përfundim të çdo semestri, nxirren statistika për secilin pedagog, duke analizuar përdorimin dhe angazhimin e tyre në këtë platformë.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Platforma dinamike https://afa.mil.al/ përditësohet rregullisht, duke ofruar informacione të detajuara mbi programet e studimit, strukturën organizative dhe personelin akademik. Informacionet mbi programet e studimit, ofertat akademike, personelin akademik dhe aktivitetet e institucionit publikohen në faqen zyrtare të AFA-së, e cila është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe anglez.			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka një sistem të brendshëm menaxhimi që mbështet administrimin, informimin dhe monitorimin e aktiviteteve akademike, financiare dhe administrative. Ky sistem është i disponueshëm për të siguruar një menaxhim efikas dhe të integruar të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxheti Vjetor dhe Afatmesëm i AFA hartohet çdo vit në muajin tetor dhe miratohet nga Senati dhe Bordi i Administrimit. Për zbatimin e tij, përgjegjëse janë Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt-buxheti hartohet duke siguruar një raport të balancuar mes të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet me prioritet. Veprimet financiare të AFA realizohen ekskluzivisht përmes sistemit bankar, duke garantuar transparencë të plotë. Raportet financiare hartohen në nivel institucional dhe nuk ndahen sipas programeve specifike, për shkak të natyrës së institucioneve jo publike të arsimit të lartë. <i>Evidenca 57 – Rregullore e Brendshme për Administrimin, Financat dhe Kontabilitetin e AFA-së dhe Evidenca 58 – Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike në AFA</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional, duke përfshirë të gjitha kostot dhe të ardhurat e institucionit. Për shkak të përmasave të AFA-së, si dhe përfshirjes së infrastrukturës dhe personelit në programe të ndryshme, nuk është e lehtë të hartohen raporte të detajuara sipas programeve të studimit. Procesi i hartimit të buxhetit nis nga njësitë bazë, kalon në njësitë kryesore, dhe më pas Rektorati e përcjell draftin në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit, buxheti kthehet për zbatim. Projekt-buxheti pasqyron politikat e zhvillimit të institucionit, duke synuar përmbushjen e nevojave kryesore, të cilat përfshijnë logjistikën e mësimdhënies, personelin akademik, veprimtarinë shkencore, si dhe pasurimin e bibliotekës.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Veprimtaria financiare e AFA-së auditohet nga Auditorët Ligjorë të Pasqyrave Financiare, në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar. Që prej miratimit të Statutit të ristrukturuar, sipas Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, auditimi në AFA kryhet nga

	Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Mbrojtjes, sipas një plani dhe grafiku të miratuar nga MM. Pasqyrat Financiare të Institucionit publikohen çdo vit, duke siguruar transparencë mbi kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, kategorizimin në llogaritë përkatëse dhe përdorimin e fondeve për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbime ndaj studentëve. Pas përfundimit të procesit, hartohet Raporti i Auditimit, i cili depozitohet pranë QKR-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare. <i>Evidenca 57 – Rregullore e Brendshme për Administrimin, Financat dhe Kontabilitetin e AFA-së dhe Evidenca 58 – Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike në AFA</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Buxheti i AFA hartohet dhe miratohet sipas Statutit dhe Rregullores së Brendshme, me përfshirjen e Administratorit dhe Zyrës së Financës. Ai detajon zërat specifike të shpenzimeve dhe mbikëqyret nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, e cila raporton për realizimin e tij në fund të vitit. Projektbuxheti reflekton politikat e zhvillimit të institucionit, duke synuar mbështetjen e mësimdhënies, personelit akademik, aktiviteteve shkencore dhe pasurimin e bibliotekës.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	AFA siguron zbatimin e politikave financiare përmes një strukture të posaçme, e drejtuar nga Drejtori i DSHM, e cila harton dhe zbaton Programin Financiar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe standardet kombëtare. Zyra e Financës është përgjegjëse për respektimin e parimeve dhe standardeve të kontabilitetit, duke mbajtur llogaritë e aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve. Pasqyrat financiare janë të qarta, të besueshme dhe përgatiten sipas parimeve të transparencës, stabilitetit dhe krahasueshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Evidenca 59, 60 dhe 61,</i>			
Konkluzione	<i>AFA siguron financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, për mbarrëvajtjen e programit të studimit dhe për mbështetje të studentëve, duke siguruar burime të mjaftueshme për këto aktivitete.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Politika dhe procedura e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në FARSH, ciklet e studimit në AFA bazohen në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet ligjore të Ministrisë së Mbrojtjes për pranimin e studentëve. Plani i Zhvillimit Strategjik përcakton kuotat e pranimit sipas nevojave të FA-ve dhe synon krijimin e kushteve studentore në standardet e akademive ushtarake të NATO-s. <i>Evidenca 23 – Politika dhe procedura e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në FARSH</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në programet e studimit të AFA, pranimi i studentëve bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë (LAL), aktet nënligjore dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave mbi notën mesatare në hyrje. Kuotat e pranimit përcaktohen me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të AFA.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	AFA përcakton qartë kriteret dhe procedurat e pranimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, duke u mbështetur në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe aktet rregullative. Këto kriteret publikohen në faqen zyrtare të AFA-së dhe në ambientet e institucionit. AFA mirëpret studentë nga Kosova, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore të MAS dhe Marrëveshjen Dypalëshe. Çdo vit akademik, në përputhje me afatet e përcaktuara nga MAS, AFA publikon oraret e regjistrimit dhe transferimeve, duke i shpallur ato në faqen zyrtare www.afa.mil.al . Pranimi i studentëve realizohet sipas kuotave dhe kriterëve të miratuara për çdo program studimi, të cilat publikohen online, së bashku me informacionin mbi procedurën e aplikimit dhe udhëzimet përkatëse të MAS. <i>Evidenca 27 – Foto e SHARE WEB dhe Evidenca 22 – Vendimi i Senatit Akademik nr. 35, datë 12.07.2022,</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së	Procesi nga pranimi deri në diplomim mbështetet në legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatëse, si dhe në burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Informacioni mbi kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online në faqen zyrtare të AFA (www.afa.edu.al)

studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	/ afa.aaf.mil.al), në broshurën informuese, fushatat mediatike dhe këshillimin institucional. AFA ndjek ecurinë e studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura specifike për mbështetjen e tyre akademike dhe profesionale.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Faqja zyrtare e AFA (https://afa.mil.al) ofron informacion të përditësuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, mbi aktivitetet akademike, konferencat, trajnimet dhe njoftimet institucionale. AFA përdor gjithashtu rrjetet sociale për të informuar studentët aktualë dhe ata potencialë mbi programet e studimit dhe jetën akademike. Këshilli Studentor i FMS luan një rol kyç në informimin e studentëve mbi jetën akademike dhe ushtarake, ndërsa Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit (DAK), përmes sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Promovimin, siguron orientimin dhe këshillimin e studentëve për programet e studimit dhe karrierën. Komunikimi i jashtëm realizohet edhe përmes faqes zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes (https://mod.gov.al), ku studentët mund të gjejnë informacion të plotë mbi ofertën akademike dhe strukturën e programeve.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	E pa aplikueshme për shkak të natyrës së veçantë të programit të studimit
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	AFA mirëpret studentët e huaj dhe ata nga diaspora, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore të MAS, Rregulloren e Brendshme dhe rregulloret e programeve të studimit. Regjistrimi dhe transferimi i studentëve realizohet në përputhje me afatet dhe udhëzimet e përcaktuara nga MAS. <i>Evidenca 22 – Vendimi i Senatit Akademik nr. 35, datë 12.07.2022,</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Studentët e ciklit të parë Bachelor në AFA trajtohen financiarisht nga buxheti i shtetit. Ata nuk paguajnë asnjë tarifë shkollimi. Po kështu, veprimtaritë ekstra-kurrikulare dhe pjesëmarrja në Federatën Shqiptare të Sportit Universitar të Sporteve financohen nga buxheti i AFA-së dhe të ardhurat që sigurohen nga të tretët
Konkluzione	<i>AFA ka politika dhe procedura të qarta për pranimin, përzgjedhjen, vlerësimin dhe diplomimin e studentëve në programet e studimit. Këto procedura sigurojnë një proces të drejtë dhe transparent për përparimin dhe njohjen e dijeve të studentëve përsërisht.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët e programit Bachelor “Studime në Shkenca Ushtarake” informohen mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik nga sekretaria mësimore dhe stafi akademik gjatë javës së parë të orientimit. Për çdo lëndë, orientimet specifike janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse. <i>Evidenca 3 – Rregullore Programi dhe Evidenca 28 – Syllabuset e Programit të Studimit “Studime në Shkenca Ushtarake”,</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në Rregulloren e Programit Bachelor “Studime në Shkenca Ushtarake”, Akademia e Forcave të Armatosura përcakton procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe studimeve të pjesshme të studentëve, duke vlerësuar rastet individuale në përputhje me kriteret akademike të institucionit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Akademia e Forcave të Armatosura informon studentët mbi format e studimeve dhe verifikimin e dijeve të fituara në këtë program. Për çdo lëndë, orientimet specifike janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse. <i>Evidenca 3 – Rregullore Programi dhe Evidenca 28 – Syllabuset e Programit të Studimit “Studime në Shkenca Ushtarake”,</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Komisioni vlerëson se Akademia e Forcave të Armatosura ,në bazë të Rregullores së Programit Bachelor “Studime në Shkenca Ushtarake”, informon studentët mbi veprimtarinë formuese të punimit të diplomës dhe procedurat/kriteret përkatëse të punimit të sa
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Vlerësohet se informimi i kandidatëve të mundshëm për çdo student kryhet nëpërmjet faqes zyrtare web, rrjeteve sociale dhe publicitetit, vizitave të të interesuarve për student në institucion dhe botimit të broshurës informuese

Konkluzione	<i>AFA ofron informacion të qartë dhe të plotë për studentët mbi përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe procesin e diplomimit. Kjo siguron transparencë dhe mbështetje për studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë javës së orientimit, studentët e rinj informohen nga Dekani, Përgjegjësi i Njesisë Bazë dhe Personeli Akademik mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit Bachelor “Studime në Shkenca Ushtarake”. Ky proces bazohet në Rregulloren e Programit të Studimit, duke siguruar një kuptim të plotë të kërkesave akademike dhe organizative.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Vlerësohet se informacioni i vihet në dispozicion studentëve edhe nëpërmjet faqes zyrtare ëeb, broshurës vjetore dhe syllabuseve të lëndëve.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Komisioni vlerëson se Zyra e personelit informon studentët mbi punësimin dhe i orienton studentët për vendet e punës se ku do të punojnë. Studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Studime në Shkenca Ushtarake” do të punësohen menjërrë pasi ata përfundojnë studimet
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët e programit Bachelor “Studime në Shkenca Ushtarake” informohen në mënyra të ndryshme mbi kalendarin akademik, orarin mësimor, sallat dhe laboratorët ku zhvillohet procesi mësimor. Që nga momenti i regjistrimit deri në përfundimin e studimeve, studentëve u vihet në dispozicion informacioni i nevojshëm mbi proceset akademike. Sekretarja e Bachelor-it, përgjegjëse për Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, mban kontakte të rregullta me studentët përmes njoftimeve elektronike dhe telefonike. Çdo ndryshim në orar apo organizim i njoftohet studentëve përmes njoftimeve të sekretares dhe këndit të njoftimeve. Informacionet mbi kalendarin akademik dhe aktivitetet mësimore dërgohen gjithashtu përmes postës elektronike.

	<i>Evidenca 67 – Orari i Veprimeve dhe Evidenca 68 – Programi Mësimor, viti II, Grupi I dhe II,</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Vlerësohet se gjatë vitit akademik 2020-2021 e në vazhdim stafi i IT i AFA-së ka përshtatur SHARE folderin sipas nevojave të Akademisë së Forcave të Armatosura. Studentët e kanë shfrytëzuar dhe e kanë pasur tërësisht funksional këtë sistem			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë siguron informacion të detajuar dhe të plotë për studentët mbi objektivat formuese, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion përfshin gjithashtu rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Viti akademik 2023-2024 është brezi i parë i të diplomuarve, dhe të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe punësimin e tyre janë të regjistruara në bazën e të dhënave përkatëse Institucioni mban statistika të lidhura me cilësinë në hyrje dhe dalje, si dhe punësimin gjatë dhe pas diplomimit për secilin program studimi. Për programin Bachelor "Studime në Shkenca Ushtarake" numri i studentëve ndër viti është: 2021-2022 54 studentë 2022-2023 38 studentë 2023-2024 36 studentë
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	AFA disponon statistika të detajuara mbi studentët për të gjitha programet e studimit. Për programin Bachelor "Studime në Shkenca Ushtarake", ecuria akademike ka qenë pozitive, dhe gjatë viteve akademike 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024, nuk ka pasur tërheqje apo largime nga programi. <i>Evidenca 69 – Të dhëna mbi regjistrimet, ç'rregjistrimet dhe të diplomuarit e Ciklit të Parë të Studimeve, programi Bachelor</i>

zhvillohet programi i studimeve.				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Akademia e Forcave të Armatosura është duke implementuar sistemin "Pitagora", i ofruar nga RASH, Ky sistem informatik do të administrojë të dhënat akademike dhe do të mbështesë funksionimin e Akademisë, me menaxhimin teknik të sistemit të udhëhequr nga Zyrën IT për menaxhimin e informacionit të studentëve dhe raporteve statistikore.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Fakulteti monitoron ecurinë e studentëve të programit përmes regjistrave të lëndëve dhe të dhënave të mbledhura nga stafi akademik, duke përfshirë prezencën, mungesat, pjesëmarrjen aktive, angazhimin në projekte, detyrat e kursit dhe vlerësimet. Ky proces plotësohet edhe përmes Sistemit Pitagora të ofruar nga RASH, ku stafi akademik regjistron dhe ndjek ecurinë e studentëve, ndërsa studentët kanë akses në të dhënat e tyre, duke përfshirë mungesat dhe vlerësimet. Njësia Bazë harton raporte analitike vjetore mbi cilësinë e hyrjes dhe daljes së studentëve, fushat e ekspertizës dhe punësueshmërinë e tyre, ndërsa Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar përmes Zyrës së Personelit të AFA. <i>Evidenca 16 – Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit,</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Vlerësohet se Njësia Bazë harton raporte vjetore analitike mbi fushat e ekspertizës së këtij programi studimi, cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre. Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontaktet me studentët e diplomuar nëpërmjet zyrës së personelit të AFA			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë mbledh dhe administron të dhëna të detajuara mbi studentët nga pranimi deri në diplomim, duke përfshirë informacion mbi punësimin e tyre. Kjo mundëson një mbikëqyrje të plotë të progresit akademik dhe profesional të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Rregullore e AFA, statuti dhe rregullorja e AFA përcaktojnë qartë rolin Këshillit Studentor, duke garantuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Studentët përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. AFA inkurajon pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, organizim të lirë dhe shprehjen e mendimit. Këshilli Studentor koordinon përfaqësimin në organet drejtuese, ndërsa përfaqësues studentorë marrin pjesë në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe NJBSC. Gjithashtu, mbledhjet mujore të departamenteve janë të hapura për studentët. <i>Evidenca 1 – Statuti i AFA-së, Evidenca 1.1 – Statuti i AFA-së i ndryshuar dhe Evidenca 2 – Rregullore e AFA</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Akademia e Forcave të Armatosura garanton pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve në procese vendimmarrëse, duke përfshirë Senatin Akademik, komisionet përhershme, Këshillin e Etikës, NJBSC dhe mbledhjet e departamenteve. Propozimet dhe vlerësimet e studentëve merren parasysh në diskutimet e nivelit drejtues të institucionit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. Një student i programit Bachelor "Studime në Shkenca Ushtarake" është pjesë e GVB-së për hartimin e këtij raporti. Këshilli Studentor ka organin e tij informativ, revistën "Studenti Ushtarak", e cila pasqyron aktivitetet akademike, kulturore dhe sportive, dhe aspekte të tjera të jetës studentore. Botimi i revistës financohet nga buxheti vjetor i AFA. <i>Evidenca 1 – Statuti i AFA-së, Evidenca 1.1 – Statuti i AFA-së i ndryshuar, Evidenca 2 – Rregullore e AFA dhe Evidenca 70 – Revista e Studentit,</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Programi i studimit Bachelor "Studime në Shkenca Ushtarake" nuk ka pësuar rishikime, pasi viti akademik 2020-2021 ka qenë viti i parë i tij. Pyetësorët dhe mbledhjet e hapura të departamenteve përdoren për të matur perceptimin e studentëve, dhe gjetjet nga këto aktivitete mund të ndikojnë në ndryshimet e mundshme të programit në vitet që do të pasojnë.

Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Syllabuset e Programit të Studimit “Studime në Shkenca Ushtarake”, kontrolli dhe vlerësimi i dijeve është një proces transparent, i cili pasqyrohet në rregulloret e brendshme dhe në syllabuset e secilës lëndë. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm janë tregues të transparencës dhe barazisë në procesin e vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashetrojnë kërkesat e tyre përmes formularëve të përkatës. Pas provimeve ndërmjetëse dhe finale, zhvillohet një seancë sqaruese, ku studentët njoftohen me vlerësimin e punës së tyre. Nëse ka mospërputhje në vlerësim, komisioni i dy pedagogëve bën rivlerësimin dhe pasqyron rezultatin e ri në test dhe sekretari. Në rast ankese për vlerësimin e një komponenti, studenti mund të drejtohet me kërkesë të shkrim të përgjegjësi i njësisë bazë, i cili ngre komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen e një vendimi përfundimtar, i cili mund të jetë i njëjtë, më i lartë apo më i ulët se vlerësimi origjinal. <i>Evidenca 3 – Rregullore Programi dhe Evidenca 28 – Syllabuset e Programit</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë angazhon studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese për të kontribuar në hartimin, miratimin dhe përmirësimin e programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies. Kjo mundëson përfshirjen e studentëve në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së burimeve dhe shërbimeve që ofrohen atyre</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Personelit janë njësitë përgjegjëse për informimin dhe shërbimin e studentëve. Këto zyra ndjekin ecurinë e studimeve të studentëve që nga regjistrimi deri në diplomim, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Seancat e tutoriatit dhe këshillimit akademik, si dhe këshillimi i karrierës nga këshilluesit përkatës të departamenteve/fakulteteve janë gjithashtu në shërbim të informimit dhe mbështetjes së studentëve.

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Komisioni vlereson se DAK harton planin vjetor të punës në mbështetje të informimit, këshillimit, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	DAK është strukturë përgjegjëse për organizimin, menaxhimin dhe drejtpërdorjen e procesit të rekrutimit të studentëve, duke mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejtuar procesin e këshillimit të studentëve, dhe ofruar asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin akademik, por është plotësues për të kompletuar procesin mësimor, duke orientuar studentët për praktikën profesionale dhe tregun e punës. <i>Evidenca 2 – Rregullore e AFA</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	DAK dhe Sekretaria Mësimore ndjekin gjurmimin e studentëve pas diplomimit me qëllim rritjen e punësimit të tyre, siç është e parashikuar në rregulloren e këtyre zyrave. Për studentët e programit Bachelor “Studime në Shkenca Ushtarake”, aktualisht ka informacion që të gjithë janë të punësuar, duke treguar suksesin e punësimit të tyre pas diplomimit. <i>Evidenca 2 – Rregullore e AFA dhe Evidenca 30 – Urdhëra emërimesh në detyrë,</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura dhe njësi të dedikuara për orientimin, këshillimin dhe menaxhimin e ankimimeve të studentëve, duke siguruar akses të lehtë dhe mbështetje të vazhdueshme</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni harton udhëzues për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, të cilat janë të përshtatura me nevojat e fushave të studimit dhe lëndëve përkatëse. Ky udhëzues mbështet pedagogët në përdorimin e metodave si mësimdhënia e bazuar në projekte, mësimi i bazuar në probleme dhe përdorimi i teknologjive digjitale, duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. <i>Evidenca 36 – Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Informacioni mbi realizimin e pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies, monitorimi dhe vlerësimi periodik përfshin metoda të ndryshme si vlerësimet nga studentët, analiza e materialeve mësimore, vëzhgimet e klasave dhe intervistat me stafin akademik. Këto procese vlerësojnë gjithashtu përfshirjen e elementeve inovative në mësimdhënie, si përdorimi i teknologjisë dhe metodave të reja. Vlerësimi i rregullt synon të identifikojë pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim, duke siguruar zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve arsimore. Këto mekanizma ndihmojnë gjithashtu në trajnimin dhe motivimin e stafit për të përmbushur standardet akademike dhe kërkimore. <i>Evidenca 40 – Monitorim praktike mësimore dhe stafit akademik që ndjek praktikën mësimore dhe Evidenca 44 – Informacion mbi realizimin e pyetësorit</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Institucioni siguron një mjedis gjithëpërfshirës, ku studentët janë aktivë në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve. Ky proces krijon dialog konstruktiv ndërmjet studentëve dhe stafit, duke përmirësuar cilësinë mësimore. Përfshirja e studentëve realizohet përmes pyetësorëve, anketave dhe forumeve, dhe janë krijuar kanale transparente për trajtimin e ankimimeve të studentëve.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie kanë një rol kyç në transparencën e procesit edukativ. Bërja publike e rezultateve të vlerësimit ndihmon në rritjen e transparencës duke bërë të njohura rezultatet për studentët, stafin akademik dhe publikun, çka kontribuon në krijimin e besimit në sistemin e vlerësimit dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Po ashtu, publikimi i rezultateve informon studentët dhe stafin mbi efektivitetin e metodave të përdorura dhe mbi rezultatet e arritura, duke ndihmuar në krijimin e një kulture të përgjegjshmërisë dhe angazhimit në përmirësimin e vazhdueshëm.

	<i>Evidencë 71 – Rezultate ankete</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Vlerësohet zbatimi i masave përmirësuese. Publikimi i rezultateve ndihmon në identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe mundëson ndjekjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie			
Konkluzione	<i>AFA ka një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, duke hartuar udhëzues të posaçëm për zhvillimin dhe monitorimin e metodave të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Evidencat 1, 1.1, 2, 72 dhe 73, sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në Akademinë e Forcave të Armatosura është i konceptuar dhe funksionon në përputhje me standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë. Me miratimin e Ligjit nr. 80/2015, NJBSC ka vepruar si një njësi organizative e përhershme dhe aktualisht funksionon në AFA, në përputhje me Vendimin e Senatit Akademik nr.31, datë 03/03/2023, për "Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Akademinë e Forcave të Armatosura". Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke garantuar që veprimtaria e tij është në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe akte të tjera rregullatore, ndërkohë që objektivat strategjike të vizionit dhe misionit të institucionit vazhdojnë të drejtojnë punën e përditshme të strukturave drejtuese, personelit akademik dhe atij administrativ.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe	Bazuar në Evidencat 1, 1.1, 2, 72 dhe 73, funksionimi i njësisë është i garantuar nga statuti i Akademisë së Forcave të Armatosura (Neni 77) dhe Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë në AFA. NJBSC është mbështetur nga burime të nevojshme njerëzore, duke përfshirë personelin akademik të AFA-së dhe përfaqësues të studentëve, që sigurojnë zbatimin e të gjitha objektivave dhe funksioneve të saj. Gjatë periudhës së funksionimit, anëtarët e njësisë janë individë me përvojë dhe kontribuojnë në proceset e garantimit të cilësisë.

bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.				
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	NJBSC ka si funksion kryesor garantimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj në përputhje me objektivat e përcaktuara. Statuti përcakton që Senati Akademik është organi përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke ndjekur standartet shtetërore. Në vitin akademik 2017, Akademia e Forcave të Armatosura realizoi Akreditimin Institucional nga ASCAL-i. Pas këtij procesi, AFA mori Çertifikatën e Akreditimit Institucional për një periudhë 3 vjeçare. Të gjitha vetëvlerësimet e brendshme dhe vlerësimet e jashtme në AFA janë realizuar duke u mbështetur në dokumenta, procedura, anketa, si dhe takime me palët e interesuara. <i>Evidencat 74, 72 dhe 73,</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni përdor tregues cilësorë dhe sasiorë për të monitoruar progresin e programeve të studimit, duke përfshirë rezultatet e performancës akademike, efikasitetin e mësimdhënies, nivelin e përfshirjes së studentëve në kërkime, dhe kënaqësinë e përgjithshme të aktorëve të përfshirë. Bazuar në këto të dhëna, institucioni zhvillon politika dhe strategji për të nxitur performancën e stafit dhe studentëve, duke krijuar stimuj për arritje më të larta akademike dhe profesionale. <i>Evidencën 71 – Rezultate ankete</i>			
Konkluzione	<i>AFA ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta dhe transparente për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, brenda strukturave të tij të brendshme të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i	AFA monitoron në mënyrë të vazhdueshme programet e studimeve, duke përdorur procedura të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me standartet shtetërore të cilësisë. Rezultatet e pyetësorëve, të realizuara periodikisht nga NJSBC për lëndët dhe infrastrukturën, shërbejnë si instrumente për vlerësimin e vazhdueshëm të arritjes së objektivave të programeve dhe për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës dhe infrastrukturës. NJSBC

shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	realizon vlerësimin e ecurisë së programeve përmes instrumenteve matëse dhe vlerësuese, si sondazhe për studentët dhe staf, që kryhen nëpërmjet pyetësorëve për pedagogët dhe programin e studimit. Vlerësimi i pedagogëve realizohet çdo fund semestri dhe është një indikator për cilësinë, etikën dhe solemnitetin e procesit mësimdhënës. <i>Evidencën 71 – Rezultate ankete</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Vlerësohet nga komisioni se raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. NJBSC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	NJBSC për kryerjen e vlerësimit përdor metoda të tërthorta që përfshijnë vrojtime në orët mësimore në auditor, rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë, rezultatet nga studentët në teste ndërmjetëse dhe finale, si dhe praktikatat profesionale, rezultatet nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi, referate, projekte, etj.), vrojtime gjatë kryerjes së praktikës dhe rezultatet nga provimi përfundimtar të formimit. <i>Evidencën 71 – Rezultate ankete</i>



Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	NJBSC përdor një gamë metodash vlerësimi, përfshirë vëzhgime në orët mësimore, analizimin e rezultateve të provimeve, testet ndërmjetëse, si dhe rezultatet nga praktikat profesionale dhe detyrat e kryera. Gjithashtu, metoda të drejtpërdrejta, si takimet me autoritetet drejtuese dhe vëzhgimi i angazhimit të studentëve, kontribuojnë në vlerësimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit.			
Konkluzione	<i>AFA ka krijuar mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të programit të studimit përmes njësive të posaçme, duke realizuar vlerësime periodike. Këto procese sigurojnë që objektivat formuese dhe rezultatet e synuara të të nxëniet të arrihen dhe të përmirësohen vazhdimisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Funksionimi i njësive garantohej nga statuti i Akademisë së Forcave të Armatosura (Neni 77), Rregullore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të hartuar në përputhje me Kodin e Cilësisë. Gjatë periudhës së funksionimit të saj, NJBSC është pajisur me burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar objektivat dhe funksionet e saj. Anëtarë të njësive janë personel akademik me eksperiencë, si dhe përfaqësues të studentëve. <i>Evidenca 72 Vendim SA për rregulloren e NjSBC; Evidenca 73 Rregullores për Sigurimin e Cilësisë në AFA,</i>

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	NJBSC është njësi operative e përhershme në strukturën organizative të AFA, e ngritur në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e AFA, dhe funksionon bazuar në rregulloren për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Struktura e NJSBC përfshin pedagogë, ekspertë të jashtëm dhe studentë. Kjo njësi vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore të AFA, duke evidentuar veprimet për përmirësim të mëtejshëm, të cilat i bëhen të njohura fakulteteve dhe departamenteve. <i>Evidenca 75 Vendim Senati Akademik për NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Vlerësohet se në dokumentin që rregullon veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar. Në sigurimin dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë në kuadër të AFA janë të përfshira të gjitha palët e interesuara
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Vlerësohet se në përzgjedhjen e anëtarëve të NJBSC, merren parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për vlerësim, dhe shkalla e njohjes së nevojshme. Gjithashtu, anëtarët nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të AFA-së.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	NJBSC ka në përbërje të saj ekspertë të jashtëm, të cilët ofrojnë ekspertizë dhe mendime të vlefshme profesionale në lidhje me cilësinë e programeve dhe përmirësimin e saj. <i>Evidenca 75 Vendim Senati Akademik për NJSBC</i>
Konkluzione	<i>AFA ka përfshirë njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme (SBC) të programeve të studimit përmes aktiviteteve të rregullta konsultuese dhe mbledhjes së sugjerimeve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, Komisioni vlerëson se NJBSC-ja zhvillon veprimtarinë e saj të organizuar sipas një plani kalendarik (plan veprimi) të përvitshëm, ku programohen monitorimet në sektorët dhe proceset që i nënshtrohen vlerësimit, dhe që shoqërohen me raportet dhe gjetjet përkatëse.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, raportet e NJBSC-së, që përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, diskutohen vetëm në grupet përkatëse ku ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë. Kur të dhënat konsiderohen me një sensibilitet të lartë, ato trajtohen nga strukturat drejtuese në takime individuale me personat përkatës..
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, të dhënat e përfuara nga vetëvlerësimet periodike shërbejnë për analizimin e situatës dhe identifikimin e problematikave, duke synuar marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Të dhënat, pas përpunimit, përdoren gjerësisht për mbështetje të procesit. <i>Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë, përmenden zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për aspekte didaktike dhe kërkimin shkencor, si dhe inkurajimi i stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, të gjithë dokumentet, procedurat dhe instrumentet e përmendura dëshmojnë se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë sigurohet përmes pjesëmarrjes në strukturat e garantimit të cilësisë dhe

ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	shpërndarjes së informacionit përmes rregulloreve dhe aktiviteteve si Java e orientimit dhe struktura të tjera brenda institucionit.			
Konkluzione	<i>Standardi VI.5 është përmbushur përmes publikimit dhe transparencës së politikave, proceseve dhe veprimtarive për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë efektive dhe synojnë krijimin e një kulture të brendshme cilësie në institucion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Studime në Shkenca Ushtarake" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Akademia e Forcave të Armatosura"

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Infrastruktura optimale dhe numri i studentëve janë brenda kapaciteteve standarde të mësimdhënies.
2. Rritja e bashkëpunimit akademik dhe shkencor me institucione brenda dhe jashtë vendit.
3. Niveli i lartë i ndërveprimit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve.
4. Programi Bachelor në "Studime në Shkenca Ushtarake" është në përputhje me vizionin, misionin dhe planin strategjik të institucionit.
5. Programet e studimit respektojnë standardet akademike dhe kërkesat për metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Pika të dobta:

1. Nevoja për mbështetje më të madhe financiare për aktivitetet kërkimore-shkencore në nivel institucional. (Standardi VI5 kriteri 3)
2. Si program i ri studimi, kërkon kohën e nevojshme për t'u integruar plotësisht në proceset e tij, duke qenë se vjen për herë të parë në zbatim.
3. Mungesa e materialeve dhe teksteve të shkruara në gjuhën shqipe për fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. (Standardi IV3 kriteri 4)

Rekomandime:

1. Përcaktimi i burimeve të mjaftueshme financiare për mbështetje të kërkimeve shkencore.
2. Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera për të përshpejtuar integrimin e programit.
3. Hartimi dhe përkthimi i teksteve dhe materialeve në gjuhën shqipe për fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Military Science Studies" at the Higher Education Institution "Academy of Armed Forces"

- The optimal infrastructure and student numbers are within the standard teaching capacity.
- Increased academic and scientific collaboration with institutions both domestically and internationally.
- High level of interaction between faculty and students.
- The Bachelor's program in "Military Science Studies" aligns with the institution's vision, mission, and strategic plan.
- The study programs comply with academic standards and requirements for teaching and learning methods.

Weaknesses:

- The need for greater financial support for research activities at the institutional level.
- As a new program, it requires the necessary time to fully integrate into its processes.
- Lack of materials and texts written in the Albanian language for the field of defense and security.

Recommendations:

- Allocation of sufficient financial resources to support scientific research.
- Increase collaboration with other institutions to accelerate the integration of the program.
- Development and translation of texts and materials into the Albanian language for the field of defense and security.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X